



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1303 prot.  
3

Tiranë, më 01/04/2020

URDHËR

Nr. 216, datë 01.04.2020

PËR

**NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR.190, DATË 19.03.2020 "PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ÇERDHEVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT COVID-2019"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "a", të Ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

**URDHËROJ:**

1. Në pikën 1, të Urdhrit Nr. 190, datë 19.03.2020 "Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019", togfjalëshi "deri në datën 03.04.2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI  
**Ogerta Manastirliu**